



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

*Ex officio*

Rasti Nr. 376/2018

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

*Kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete*

**Drejtuar:**

- **Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**
- **Znj. Sala Berisha-Shala, Kryetare e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**
- **Znj. Albulena Haxhiu, Kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**
- **Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Republikës së Kosovës**
- **Z. Pal Lekaj, Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës**

**Prishtinë, më 5 tetor 2018**

## PËRMBAJTJA

QËLLIMET E RAPORTIT .....	2
BAZA LIGJORE .....	2
ANALIZA JURIDIKE.....	3
KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT.....	7
A. Konstatimi i Avokatit të Popullit .....	7
B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit.....	8

## QËLLIMET E RAPORTIT

1. Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete, neni 43, par. 2 (në tekstin e mëtejshëm: “Ligji për Automjete”), parashikon se: “Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor”.
2. Ky Raport ka tri qëllime kryesore:
  - (1) Për të shpjeguar hollësisht nenin 46, par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“E drejta e pronës është e garantuar”) dhe mënyrën se si duhet zbatuar kjo dispozitë në sistemin juridik të Republikës së Kosovës;
  - (2) Për të analizuar, në bazë të këtij shpjegimi, nëse neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete paraqet shkelje të së drejtës së pronës dhe
  - (3) Për t’u dërguar institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete për ndryshimin e Ligjit për Automjete për të qenë në përputhje të plotë me të drejtën kushtetuese të pronës.

## BAZA LIGJORE

3. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (ex officio), nëse . . . ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (neni 16, par. 4);
  - “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 2);
  - “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
  - “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
  - “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).
4. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në



media, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi ligjore.

### ANALIZA JURIDIKE

5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Kushtetuta”) përcakton se: “E drejta e pronës është e garantuar” (*po aty*, neni 46, par. 1).
6. Sipas nenit 53 të Kushtetutës, “[t]ë drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.
7. Prandaj, për të vlerësuar saktë nëse neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete paraqet shkelje të së drejtës së pronës, duhet të bazohemi tek vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (në tekstin e mëtejshëm: “GJEDNJ”).
8. Vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së, në lidhje me të drejtën e pronës, bazohen tek neni 1 i Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: “KEDNJ”). Sipas nenit 22 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në KEDNJ dhe Protokollin e saj “garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.
9. Neni 1 i Protokollit të Parë të KEDNJ-së ndahet në dy paragrafë:

[Par. 1] Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

[Par. 2] Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshme ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

10. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së, këta dy paragrafë konsiderohen që të përmbajnë gjithsej tri rregulla (“rules”). Rregulli i parë përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë, rregulli i dytë përcaktohet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë dhe rregulli i tretë përcaktohet në paragrafin e dytë.
11. Sipas Gjykatës, “[r]regulli i parë, i cili është i një natyre të përgjithshme, e shpall parimin e gëzimit paqësor të pronës . . . . Rregulli i dytë mbulon çështjen e privimit të posedimeve dhe vendos disa kushte mbi të . . . . Rregulli i tretë përcakton se Shtetet e kanë të drejtën, mes të tjerash, të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i konsiderojnë të domosdoshme për këtë qëllim” (*Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë*, GJEDNJ, Aplikimet Nr. 7151/75 dhe 7152/75 (1982), § 61).

12. Megjithatë, GJEDNJ e ka bërë të qartë se: “Tri rregullat nuk janë . . . të ndara në kuptimin e të qenit të palidhura me njëri-tjetrin. Rregulli i dytë dhe rregulli i tretë kanë të bëjnë me lloje specifike të kufizimit të së drejtës së gëzimit paqësor të pronës dhe, prandaj, duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të shpallur në rregullin e parë” (*Kozacioglu kundër Turqisë* [GC], GJEDNJ, Aplikimi Nr. 2334/03 (2009), § 48).
13. Brenda kësaj kornize, hapi i parë i vlerësimit është gjithmonë të analizohet nëse akti në fjalë paraqitet një *kufizim* të gëzimit paqësor të pronës. Prandaj, në rastin konkret, duhet të analizohet nëse neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete paraqet një kufizim të tillë.
14. Kjo dispozitë kufizon qartazi gëzimin paqësor të pronës, përkatësisht, gëzimin paqësor të automjetit nga ana e pronarit të tij. Është e vërtetë se dispozita në fjalë nuk e privon *shprehimisht* pronarin nga posedimi i automjetit. Mirëpo, GJEDNJ e ka bërë të qartë se, konsiderohet një kufizim i së drejtës së pronës kurdoherë që aktet e autoriteteve publike “*në praktikë*, kanë ulur mundësinë e ushtrimit të asaj [të drejte]” (*Sporrong*, GJEDNJ, *op. cit.*, § 60; theks i shtuar).
15. Është tepër e qartë se neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete, në praktikë, e ul mundësinë e ushtrimit të së drejtës për të shfrytëzuar automjetin si pronë. Sipas vetë këtij Ligji, “[n]ë mënyrë që të marrin pjesë në trafik rrugor, mjetet duhet të jenë të regjistruara” (*po aty*, neni 39, par. 1). Kjo do të thotë se, kur neni 43, par. 2 përcakton se pronari “nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik . . . pa bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor”, një ndalesë e tillë, në praktikë, e privon plotësisht pronarin nga përdorimi i automjetit të vet, derisa t’i shlyejë gjobat e veta për kundërvajtje.
16. Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete, paraqet një kufizim të qartë të së drejtës së pronës.
17. Pasi që kemi gjetur një kufizim të së drejtës së pronës, hapi tjetër i vlerësimit është të analizohet nëse ka “një lidhje të arsyeshëm të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të përmbushet përmes masave të zbatuara nga Shteti” (*Kozacioglu*, GJEDNJ, *op. cit.*, § 63).
18. Bashkë me jurisprudencën e GJEDNJ-së, neni 55 i Kushtetutës na jep një shtjellim më të detajuar të konceptit të proporcionalitetit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, “testi i proporcionalitetit është përshkruar në nenin 55 të Kushtetutës” (Rasti Nr. KO131/12, Dr. Shqip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim, 15 prill 2013, par. 127).
19. Përkatësisht, neni 55, par. 4 i Kushtetutës përcakton pesë kritere për vlerësimin e proporcionalitetit të një kufizimi të një të drejte të njeriut: “Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e



pushtetit publik . . . e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes (1) esencës së të drejtës që kufizohet, (2) rëndësisë së qëllimit të kufizimit, (3) natyrës dhe vëllimit të kufizimit, (4) raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe (5) të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël”.

20. Në rastin konkret, qëllimi që synohet të arrihet përmes nenit 43, par. 2 të Ligjit për Automjete, është për të siguruar pagimin e gjobave të shqiptuara kundër pronarëve të automjetit, ndërsa mjeti për të arritur këtë qëllim, siç u pa më sipër, është privimi i pronarëve nga përdorimi i automjeteve të tyre, derisa të shlyhen gjobat e shqiptuara.
21. Sipas kriterëve të proporcionalitetit, a mund të konsiderohet neni 43, par. 2 i Ligjit një mjet proporcional për të arritur qëllimin që të sigurohet shlyerja e gjobave?
22. Vlerësimi i dispozitës në fjalë, përderisa ajo ka të bëjë me një mjet “për të siguruar pagimin e . . . gjobave”, bëhet në kuadër të *rregullit të tretë* të nenit 1 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së.
23. Siç u theksua më sipër, “rregulli i tretë” i referohet paragrafit të dytë të nenit, i cili përcakton se: “dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme . . . për të siguruar pagimin e . . . gjobave”.
24. Është e qartë se, sipas këtij rregulli, autoritetet shtetërore gëzojnë njëfarë diskrecioni për të vendosur se cilat masa janë “të nevojshme . . . për të siguruar pagimin e gjobave. Mirëpo, Avokati i Popullit thekson se ky diskrecion nuk është pa kufi dhe duhet prapëseprapë t'i nënshtrohet testit të proporcionalitetit.
25. Avokati i Popullit konsideron se neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete dështon të kalojë testin e proporcionalitetit në dy pika në veçanti: (1) raporti midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet dhe (2) shqyrimi i mundësisë së realizimit të këtij qëllimi me kufizim më të vogël.
26. Për sa i përket pikës së parë, rasti *Rousk kundër Suedisë*, GJEDNJ Aplikimi Nr. 27183/04 (2013), është me rëndësi të veçantë për vlerësimin e Ligjit për Automjete.
27. Në këtë rast, autoritetet shtetërore shitën në ankand disa asete të aplikuesit, me qëllim që të sigurohet shlyerja e tatimeve të papaguara nga ana e tij. Por, për shkak se vlera e aseteve të shitura ishte shumë më e lartë sesa shuma e tatimeve të papaguara, GJEDNJ konstatoi se shitja e aseteve, dhe pasojat e kësaj shitjeje, “dukeshin të tepërta dhe joproporcionale, sidomos duke marrë parasysh se aplikuesi ka pasur asete të tjera . . . që do të mund të ishin konfiskuar dhe shitur për të mbuluar atë shumën e vogël që ka mbetur nga borxhet e tij të detyrueshme” (*po aty*, § 125). Me fjalë të tjera, kishte një mospërputhje serioze midis masës së kufizimit të së drejtës së pronës (shitja e aseteve me vlerë relativisht të lartë) dhe qëllimit që synohej të arrihej (shlyerja e tatimeve të papaguara me vlerë relativisht të ulët). Për këtë arsye, GJEDNJ ka konstatuar se aplikuesit i ishte shkëlur e drejta e pronës.

28. Sipas të njëjtit arsyetim, fakti që vlera e një automjeti, në gati çdo rast, është shumë më e lartë sesa shuma e gjobave të papaguara nga ana e pronarit të automjetit, na çon në të njëjtin përfundim si në rastin *Rousk*. Njësoj si në *Rousk*, edhe këtu mund të thuhet se ka një mospërputhje serioze midis masës së kufizimit të së drejtës së pronës të imponuar nga Ligji për Automjete (pamundësimi i plotë i shfrytëzimit të automjetit nga ana e pronarit) dhe qëllimit që po synohet të arrihet (shlyerja e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor). Për këtë arsye, Avokati i Popullit konstaton se neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete është masë joproporcionale dhe paraqet shkelje të së drejtës së pronës.
29. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se dispozita ligjore në fjalë dështon tek edhe një pikë tjetër e testit të proporcionalitetit. Përkatësisht, neni 55, par. 4 i Kushtetutës thekson detyrimin e institucioneve “të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të . . . qëllimit me kufizim më të vogël”.
30. Në rastin e nenit 43, par. 2 të Ligjit për Automjete, Kuvendi ka dështuar të përmbushë këtë obligim, në dy aspekte.
31. Së pari, Avokati i Popullit konsideron se, Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje është i rëndësishëm për analizën e proporcionalitetit të Ligjit për Automjete, kjo për arsye se Ligji për Kundërvajtje përfshin një masë shumë më pak të ashpër për arritjen e qëllimit të njëjtë, dmth. qëllimit për të siguruar pagimin e gjobave të shqiptuara për kundërvajtje në trafikun rrugor. Përkatësisht, neni 30, par. 4 i Ligjit për Kundërvajtje përcakton se: “Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbartimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbartim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbartues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbartimore”.
32. Me fjalë të tjera, Ligji për Kundërvajtje tenton të realizojë të njëjtin qëllim si Ligji për Automjete (shlyerja e gjobave të papaguara), por pa pasur nevojë të kufizojë kaq rreptësisht të drejtën e pronarit për të shfrytëzuar automjetin e tij. Në vend të privimit të pronarit nga e drejta për të shfrytëzuar automjetin, Ligji për Kundërvajtje thjesht e detyron pronarin që t’u nënshtrohet procedurave të përbarimit, përmes të cilave sigurohet pagimi i shumës së gjobave të papaguara.
33. Avokati i Popullit vëren se ishte e pamundur që Kuvendi, përpara se të miratohej Ligji për Automjete, të kishte konsideruar nëse kjo metodë e përcaktuar nga Ligji për Kundërvajtje ishte e mjaftueshme për të arritur qëllimin e shlyerjes së gjobave, kjo për arsye se Ligji për Kundërvajtje kishte hyrë në fuqi në janar të 2017 (*shih po aty*, neni 171), **më pak se pesë muaj** përpara se të miratohej Ligji për Automjete, më 18 prill 2017.
34. Avokati i Popullit konsideron se një periudhë kaq e shkurtër nuk ishte e mjaftueshme për të shqyrtuar mirëfillt nëse qëllimi i shlyerjes së gjobave të papaguara do të mund



të zgjidhej me kufizimin më të vogël të parashikuar nga Ligji për Kundërvajtje, pa pasur nevojë të imponohet kufizimi më i rreptë i përcaktuar nga Ligji për Automjete.

35. Për rrjedhojë, Avokati i Popullit konstaton se Kuvendi ka dështuar të “shqyrtojë mundësinë e realizimit të . . . qëllimit me kufizim më të vogël” përpara se të miratonte Ligjin për Automjete, përkatësisht nenin 43, par. 2 i Ligjit. Prandaj, kjo dispozitë ligjore përbën masë joproporcionale dhe paraqet shkelje të së drejtës së pronës
36. Ka edhe një aspekt të dytë në të cilin Kuvendi ka dështuar të përmbushë kërkesën për të shqyrtuar mundësinë e realizimit të qëllimit me kufizim më të vogël.
37. Për të kërkuar nëse deputetët e Kuvendit e kanë shqyrtuar në të vërtetë mundësinë e realizimit të qëllimit me kufizim më të vogël, Avokati i Popullit ka analizuar dokumentet në vijim:
- (1) Memorandumi shpjegues i Projektligjit për Automjete, i dërguar në Kuvend nga ana e ministrisë sponsorizuese të Projektligjit, në rastin konkret, Ministria e Infrastrukturës;
  - (2) Transkripti i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 19 janar 2017 (e cila përfshinte shqyrtimin e parë të Projektligjit për Automjete; *shih po aty*, f. 98-105);
  - (3) Transkripti nga dëgjimi publik i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, të mbajtur më 8 shkurt 2017 (në të cilin u diskutua me hollësi Projektligji për Automjete dhe konsideroheshin propozime për amendamentimin e tij); dhe
  - (4) Transkripti i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 11 dhe 18 prill 2017 (e cila përfshinte shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Automjete dhe në të cilën Projektligji u miratua përfundimisht).
38. Në asnjë prej këtyre dokumenteve nuk është shqyrtuar mundësia e realizimit të qëllimit të shlyerjes së gjobave të papaguara me një kufizim më të vogël sesa neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete. Për rrjedhojë, edhe për këtë arsye, Kuvendi ka dështuar të përmbushë kriteret e proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 55, par. 4 të Kushtetutës. Andaj, neni 43, par. 2 i Ligjit mund të cilësohet si masë joproporcionale, në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të pronës.

## **KONSTATIMI DHE REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT**

### **A. Konstatimi i Avokatit të Popullit**

39. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se: Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete, neni 43, par. 2 (“Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor”) paraqet shkelje të së



drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46, par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“E drejta e pronës është e garantuar”).

#### **B. Rekomandimet e Avokatit të Popullit**

40. Në bazë të këtij konstatimi, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon që Kuvendi, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës:

- (1) Të ndryshojë Ligjin Nr. 05/L-132 për Automjete, përkatësisht, të fshijë nenin 43, par. 2 të tij;
- (2) Të analizojë nëse Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 30, par. 4 (“Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbarim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbarimore”), po funksionon në atë mënyrë që po sigurohet, në nivel të mjaftueshëm, shlyerja e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor;
- (3) Nëse neni 30, par. 4 i Ligjit për Kundërvajtje nuk është i mjaftueshëm, të shqyrtojë nëse ka një masë tjetër më pak të ashpër sesa neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete, me të cilën mund të arrihet qëllimi i shlyerjes së gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor.

41. Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit